



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2023-018

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga B.H., për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares së Gjykatës Supreme Mejreme Memaj, më 28 korrik 2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e palejuar, ankesa e B.H., e paraqitur kundër vendimit të gjyqtares M.M., të cilin e kishte marrë në cilësinë e ushtrueses së detyrës së Kryetares së Gjykata Supreme, GJS-2023-011 i datës 12.06.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme më 11 korrik 2023 përmes Zyrës së Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka pranuar ankesa e B.H., kundër vendimit GJS-2023-011, të datës 12.06.2023, të gjyqtares M.M., në atë kohë ushtruese e detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme, me të cilin është refuzuar ankesa e paraqitur nga B.H., ndaj kryetares së Gjykatës Themelore të Prishtinës, A.Sh.-R..

Kryetari i Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të cilat janë bashkëngjitur me ankesë vlerësoi se:

- Ankesa është e palejuar.

Nga shkresat e çështjes del se B.H., ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të gjyqtares M.M., GJS-2023-011 të datës 12.06.2023, dhe ka kërkuar të iniciohet procedurë disiplinore ndaj saj. Gjyqtarja M.M., në atë kohë në cilësinë e ushtrueses së detyrës së Kryetares së Gjykatës Supreme, si autoritet kompetent për të vendosur lidhur me ankesën konform dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar. 1.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur përkitazi me ankesën e B.H., ndaj kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.Sh.R., me vendimin GJS-2023-011 të datë 12.06.2023, ka vendosur se ankesa është e pabazuar.

Sipas ligjit nr.06/L-057, “Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, respektivisht nenit 9 par.1 të këtij ligji, secili person fizik dhe juridik mund të parashtror ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo tek Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën ta përcjell tek Autoriteti Kompetent. Mirëpo, me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet mundësia që personat fizik dhe juridik të parashtrorjnë kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj Autoritetit Kompetent, në rastet kur ky i fundit vendos përkitazi me ankesën e paraqitur për inicim të procedurës disiplinore ndaj ndonjë gjyqtari apo kryetari të Gjykatës, sepse për këtë veprim është i autorizuar vetëm Avokati i Popullit.

Bazuar në këto rrethana, duke vlerësuar ankesën e parashtruar së bashku me shkresat e bashkëngjitura sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të gjyqtares M.M., me rastin e nxjerrjes së vendimit GJS-2023-011, të datës 12.06.2023, konstatoj se kërkesa për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares së Gjykatës Supreme, M.M., është e palejuar.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtares M.M.,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.